



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr. 62. Prot

Gjirokastër, më 18. 01. 2023

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje për studenteët e Gjuhës Angleze në Programin e financuar nga Ambasada Amerikane dhe implementuar nga Kryqi i Kuq.

Në kuadër të Programit "Zgjerimi i aftësive përmes të mësuarit të Gjuhës Angleze", Kryqi i Kuq ka fituar një grant për kombinimin e mësimdhënies së gjuhës angleze me vullnetarizmin për fëmijët e shtresave në nevojë.

Projekti është një program extra kurrikular që do të ofrojë ndihmë për të përmirësuar aftësitë e gjuhës angleze për 60 nxënës me mundësi të kufizuara financiare nga shkolla 9-vjeçare Koto Hoxhi, për të kombinuar mësimin e gjuhës angleze dhe parimet themelore të Kryqit të Kuq si vullnetarizmi dhe angazhimi qytetar.

Projekti do të sjellë së bashku:

- mësimdhënës të Gjuhës Angleze, alumni të programit të Departamentit të Shtetit Amerikan, English E-Teacher Program ose të trajnuar nga Specialistë të gjuhës angleze dhe drejtues të rrjeteve të mësuesve të gjuhës Angleze në Gjirokastër
- studentë të gjuhës angleze të Universitetit Eqrem Çabej, të cilët do të luajnë rolin e mësuesit ndihmës duke përfituar kështu një përvojë në mësimdhënie.
- ligjërata nga specialistë amerikanë në lidhje me kulturën dhe vlerat amerikane.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **25.01.2023**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV, në shqip dhe në anglisht.

Studentët do të duhet të kalojnë një test prove të njohurive të tyre. Testi do të zhvillohet në ambientet e Universitetit "Eqrem Çabej" në datën 30. 01.2023.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

